

**Gjykata e Posaçme e Shkalles së Parë për
Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**

PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITIT 2021

Nr.	Rekomandimet e lëna	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit /veprimet që duhen ndërmarë	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	Rekomandimi nr.1: Pas çdo furnizimi me karburant të automjeteve nëpërmjet kartës elektronike përdoruesit e automjeteve të dorëzojnë së bashku me fletë udhëtimit kuponin tatimor të furnizimit të operatorit ekonomik, i cili duhet të bashkëngjitet me F.Daljen e magazinës. Në Fletë-Udhëtimet mujore të pasqyrohet sasia e furnizuar me karburant dhe data e furnizimit.	I mesëm	Faqe 15.paragrafi fundit dhe FQ 16 paragrafi I	<u>Dakort me zbatimin</u> Titullari i institucionit nxjerr urdhërin për zbatimin e këtij rekomandimi . Kancelari dhe përgjegjësi i menaxhimit të sistemit të funizimit me karburant mbikqyrin zbatimin e ketij rekomandimi .Drejtuesit e mjeteve të evidentojnë sasinë e furnizimit me karburant në fletën e udhëtimit dhe të dorëzojnë ato së bashku me kuponat tatimorë të furnizimeve periodike në sektorin e magazinës. Ekonomisja e magazinës dhe magazinierja të bashkangjisin kuponat tatimorë me fletëdaljet e magazinës si dhe rakordojnë dhe evidentojnë sasinë e kilometrave të përshkruara dhe sasinë e litrave të konsumuara sipas urdhërave në fuqi .	Menjëherë /Në proces zbatimi	Titullari, Kancelari përgjegjësi i menaxhimit të sistemit të funizimit me karburant, drejtuesit e mjeteve, ekonomisja, magazinierja
2	Rekomandimi nr.2: Autoriteti Kontraktor të prokurojë veç karburantin për automjete dhe veç karburantin për ngrohje në lote të veçanta.Në rast se nafta dhe benzina për automjete do të prokurohen bashkë,në një lot,të kërkohet që operatorët ekonomik të ofertojnë me një marzh fitimi për të dy artikujt ,në të kundërt të prokurohen në lotë të veçanta.	I mesëm	Faqe 22.paragrafi fundit dhe FQ 23 paragrafi I	<u>Dakort me zbatimin/</u> Njësia e prokurimit ,Personi përgjegjës për prokurimet proçedojnë , marrin masa dhe dokumentojnë prokurimin e karburantit për nevojat e institucionit të ndarë në lote të vecantë sipas këtij rekomandimi dhe legjislacionit në fuqi.	Në vijimësi	Njësia e prokurimit, Personi përgjegjës për prokurimet

3	<p>Rekomandimi nr.3: Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël në Urdhër prokurim të mos shënohet vlera e fondit limit, të përdorë Formatet standart të APP-së.</p> <p>-Anëtarët e komisionit, në momentin e hapjes së ofertave në SPE të plotësojnë deklaratën mbi gjëndjen e konfliktit të interesit me operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit.</p> <p>-Dokumentacioni i kërkuar në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë,të dorëzohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues,në Zyrën e Protokollit të Gjykatës.</p> <p>-Të printohet dhe të bëhet pjesë e praktikës së procedurës “Raporti përfundimtar i procedurës së prokurimit”,të gjeneruar nga SPE.</p>	I mesëm	Faqe 27-28,paragrafi fundit	<p><u>Dakort me zbatimin/</u> Përmirësimi dhe plotësimi i dokumentacionit të blerjeve të vogla nga Njësia e prokurimit per Blerjet e Vogla dhe ,Personi Përgjegjës për Prokurimet.Plotësimin e formulareve të deklaramit të konfliktit të interesit .Dokumentimi me anë të proces verbaleve të proceduarave të ndjekura.Protokollimi i dokumentave të operatorit fitues .Printimi i gjithë procedurave të ndjekura dhe krijimi dosjeve për çdo procedurë të blerjeve të vogla .</p>	Në vijimësi	Njësia e prokurimit, Personi përgjegjës për prokurimet Arkivistja
4	<p>Rekomandimi nr.4: Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, përpara se të dalë Urdhër prokurimi nga Kryetari i AK, komisioni të sigurojë ose hartojë specifikimet teknike /termat e referencës për mallrat ose shërbimet që do të prokurohen.Në bazë të së cilave të llogaritet dhe fond limit.-Në raste specifike, komisioni në varësi të llojit të objektit të prokurimit,të kërkojë plotësimin e një ose disa kritereve të veçanta ,duke përcaktuar në ftesën për oferte dokumentacionin përkatës provues.Të gjitha veprimet e mësipërme të dokumentohen në një procesverbal të veçantë.</p>	I mesem	Faqe 28-29,paragrafi I dhe I fundit	<p><u>Dakort me zbatimin/</u> Monitorimi dhe përmirësimi I vazhdueshëm i procesit të prokurimeve që në fazën e hartimit të kërkesave, dhe të kryerjes së specifikimeve teknike / termave të references .Vendosjes së kritereve të veçanta me dokumentacionin provues. Dokumentimi i hartimit të kritereve në proces verbale të veçanta.</p>	Në vijimësi	Njësia e prokurimit, Personi përgjegjës për prokurimet Arkivistja

5	Rekomandimi nr.5: Në procedurat e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajta për mjetet e transportit”, në momentin e lindjes të një difekti në mjet, ky i fundit të dërgohet për kontroll/egzaminim në një servis të specializuar, për konstatimin e difektit dhe hartimin e akt konstatimit, përfshirë këtu dhe preventivin e shpenzimeve për riparim.	I mesëm	Faqe 29-30.paragrafi I dhe I fundit	Dakort me zbatimin Ekzaminimi I defekteve të automjeteve në servise të specializuara hartimi I aktit të konstatimit dhe preventivi para fillimit e prokurimit.	Në vijimësi	Komisioni I konstatimit të defekteve,drejtuesit e mjeteve dhe njësia e prokurimit
---	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------	-------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------------------------------------------------------------------